

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Sherbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: *“Shërbimi i pastrimit,grumbullimit,largimit të mbetjeve urbane dhe gjelbërimit për Bashkinë Qendër Maliq dhe Njësitë Administrative Libonik,Pojan,Vreshtas,Pirg”*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **90910000-9**

PËRCAKTIMI DHE ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :

Specifikimet teknike ,preventivi dhe metodologjia e shërbimit per proceduren respektive jane hartuar nga njesia per llogritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve dhe metodologjise ngritur me Urdher Kryetari nr.383 Date 25.07.2023 *Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë kontrolluar dhe janë gjetur në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”*.Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

VLERA E FONDIT LIMIT:

198.755.459 *(njëqind e nëntëdhjetë e tetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e katërqind e pesëdhjetë e nëntë)lekë pa Tvsh*

238.506.550 *(dyqind e tridhjetë e tetë milion e pesëqind e gjashtë mijë e pesëqind e pesëdhjetë)lekë me tvsh*

Vlera e fondit limit është përlloritur bazuar në Ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”,Kreu VI “rregulla të përgjithshme dhe përgatitja e procesit të prokurimit”,neni 34 “Përlloraritja e vlerës së parashikuar të prokurimit”,Vendimit nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 12 “Metoda të zbatueshme në përlloraritjen e vlerës së kontratës”.Komisioni i perlloraritjes se fondit limit i ngritur me Urdher Titullari nr.380 prot date 25.07.2023 ka punuar bazuar në Ligjin Nr.10463, Datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” , i ndryshuar, Ligjit Nr.8094 datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave” Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.319 datë 31.05.2018 "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve". ***Përlloraritja e kostove të menaxhimit të mbetjeve është bërë bazuar në rregullat e prokurimit publik dhe në Vendimin Nr. 319 datë 31.05.2018 "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve"***

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, autoriteti/enti kontraktor bashkia Maliq ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e ofertes sipas shtojces 1

b. Listen e çmimeve sipas zërave të preventivit bashkengjitur sipas shtojces 2

c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3

ç. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

d. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do të kryejë shërbimet e kerkuara sipas metodologjise bashkengjitur dokumentave të tenderit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Per kapacitetin ligjor /profesional te operatoreve ekonomike:

Sipas kritereve te pergjithshme te Pranim / Kualifikimit.

Operatori ekonomik duhet të ushtrojë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi, të paraqitur në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe vërtetuar nëpërmjet ekstraktit të regjistrit tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve 2020,2021,2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 datë 19.05.2008 ,për ”Procedurës Tatimore ”neni 64 Deklarata Tatimore.

2.2.2 Kopje të vërtetuar të bilancit per vitet 2020,2021,2022 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe te shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, pranë njërive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitetet për vitin 2023 sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar.

Argumentimi.sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) Sherbime të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së kontratës që prokurohet, dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

b) Sherbime të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marre së bashku gjatë tre viteve të fundit të jetë jo më e vogël se fondi limit i kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

**Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon :

a- vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të gjitha dokumentet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 30% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (e vlefshme).

- a. Leje mjedisore të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) për pastrimin, larje rruges, fshirje rrugeshe . **(Kodi III.1.A)**

- b. Liçense e leshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) lidhur me ndikimin në mjedis të leshuar nga QKL. **(Kodi III.2.A).**
- c. Liçense e leshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) grumbullim dhe transportim të mbejtjeve urbane të leshuar nga QKL. **(Kodi III.2.B).**

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale pika a, b, c).

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në piken 2, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë” dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar , të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, Ligjin Nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011” Per mbrojtjen e mjedisit” Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, Ligji 5 95/2015, Me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

2.3.3 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, Operatori ekonomik duhet të dorëzojë:

1- Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

a) NP 12-A *(punime të inxhinierise se mjedisit)*

** Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zerave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Vendimit Nr. 943, datë 28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të këshillit të ministrave, “për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrorjnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategori a e kërkuar	Pershkrimi I kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikasi mit i kërkuar për kategori në respektiv e	Vlera e punimeve (pa tvsh) që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP 12	<i>punime te inxhinierise se mjedisit</i>	Sipas zerave ne preventiv per sherbime pastrimi ,grumbullimi dhe mirembajtje siperfaqesh te gjelberta	A	

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një **Deklarate sipas formularit permbledhes te veteklarimit (nga Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik** të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë të përfshirë në licensën e shoqërisë. Drejtuesi teknik duhet të jete :

- **Inxhinier Mjedisi (1)**

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

1. Kontratë pune (e vlefshme)
2. Diplomë
3. Çertifikate trajnimi për *”Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune”*, e dhëne nga një organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj

- Në rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të jete I pajisur me Çertifikate trajnimi për *”Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune”*, e dhëne nga një organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” në neni 41 pika 4 b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” .Duke parë natyrën e shërbimit që kërkohej është kërkuar që drejtuesi teknik të jete Inxhinier Mjedisi. Drejtuesi Teknik i shërbimit të pastrimit është përgjegjës për zbatimin e këtij shërbimi në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Duke ju referuar zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të tij , është shumë e rëndësishme për AK kapaciteti dhe përvoja e mëparshme në punë e drejtuesit teknik të këtij shërbimi që vertetohen në CV përkatëse të tij. Kriteri I mesipër për eksperiencën e drejtuesit teknik është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese për operatorët. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e shërbimit që do të realizohen dhe do të monitorohen në vazhdimësi .

2.3.5 Operatori ekonomik, duhet të përcaktojë me anë të një **Deklarate sipas formularit permbledhes të vetëklarimit** se për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- **Inxhinier mekanik (1)**

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

1. Kontratë pune (e vlefshme)
2. Diplomë

Argumentimi: Për kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.4 Njësia e Prokurimit është bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, “Për Prokurimin Publik” datë 23.12.2020, pika 4 si dhe në VKM nr 285 datë 19.05.2021 “për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” neni 41 pika 4. Me këto kriter Autoriteti Kontraktor vlereson si të domosdoshëm shërbimin e pastrimit në kohe dhe me cilesi pasi gjatë punimeve mund të ndodhin defekte makinerive që do të jene në dispozicion të kontratës dhe prania e një inxhinieri mekanik do të sigurojë autoriteti kontraktor që shërbimi nuk do të ketë vonesa Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët. Numri i stafit kryesor është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e shërbimit. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë

kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat ISO:

- **ISO 9001 – 2015** (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme)
- **ISO 14001 – 2015** (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme)
- **ISO 18001 – 2018**, (Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme)

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë certifikatën).

Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH ose standardeve shqiptare mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO, sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi. Për kriteret e përcaktuara në Kapacitetin teknik, Njësia e prokurimit ka zbatuar VKM Nr.285 date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 44 "Kërkesat e cilësisë", si dhe bazuar në Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr.8197 prot. datë 03.09.2018 për "Hartimin e Kriteve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime. Autoriteti Kontraktor kërkon që operatori ekonomik të jetë i certifikuar me certifikatat Iso .

- Për ISO 9001 – 2015 ose ekuivalente; Kjo certifikate specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synon të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatore si dhe meqënëse Bashkia Maliq si Autoritet Kontraktor kërkon që shërbimet që do të kyhen të jenë në cilësinë më të lartë është përcaktuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me këtë standart cilësie.

- Per ISO 14001 – 2015: ose ekuivalente Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 14001 – 2015 , standart ky që vlerëson sipas përkufizimit të tij përgjegjshmërinë e kompanive ndaj mjedisit dhe fokusohet në tre fusha kryesore: - Standardet e Sistemit të Menaxhimit - që vlerësojnë nivelin e sistemit të zhvillimit dhe integritetit të përgjegjësive ndaj mjedisit në të gjithë kompaninë, - Standardet Operative - që masin harxhimin e burimeve natyrore dhe energjisë në proceset operative të kompanisë, dhe - Standardet e Sistemit të Mjedisit - që masin ndotjet e ndryshme nga mbetjet. Bashkia Maliq si Autoritet Kontraktor kërkon një manaxhim të aktivitetit përkushtuar parandalimit të ndotjes dhe të përmirësimit të ndikimeve mjedisore.

- Për ISO 18001 – 2018 ose ekuivalente: Ky standart përcakton kërkesat minimale të shëndetit në punë dhe praktikat më të mira të menaxhimit të sigurisë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shendetësor optimal dhe menaxhimin e sigurisë në punë. Kjo mund të ndihmojë për të vënë në vend politikën, procedurat dhe kontrollet e nevojshme për çdo lloj biznesi për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës, një linjë me praktikën më të mirë të njohur ndërkombëtare.

2.3.7 Operatori ekonomik, duhet të përcaktojë me anë të një **Deklarate sipas formularit përmbledhes të vetëklarimit(formulari të jete i plotësuar me të dhënat e punonjesve si emer , mbiemer, profesioni)**, minimalisht 54 (pesedhjet e kater) punonjës të kualifikuar si më poshtë:

a) Shofer (9)

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/entë kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

Kur mjetet janë në pronesi

1. kontrata e punës (e vlefshme)
2. Leje drejtimi e kategorise jo me te vogel se “D”

Kur mjetet janë me qera

1. Deklarate nga operatori ekonomik, që në rastin e shpalljes fitues, do paraqese kontrate pune me shoferin i cili duhet të jete I pajisur me Leje drejtimi të kategorise jo me te vogel se “D” deri në perfundimin e afateve të kontrates.

b) Manovrator (1)

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/entë kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

Kur mjetet janë në pronesi

1. kontrata e punës (e vlefshme)
2. Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtorja e Përgjithshme e Sherbimeve të Transportit Rrugor

Kur mjetet janë me qera

- Deklarate nga operatori ekonomik, që në rastin e shpalljes fitues, do paraqese kontrate pune me manovratorin(i cili duhet të kete Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtorja e Përgjithshme e Sherbimeve të Transportit Rrugor) deri në perfundimin e afateve të kontrates.

c) Puntore të thjeshte (44)

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

1. kontrata e punës e vlefshme;

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Përprokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorë ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

a) Shofer (9)

Jane kerkuar 9 shofere sipas mjeteve qe duhet te disponoje operatori ekonomik nga zberthimi i metodologjise bashkengjitur dst.

b) Manovrator (1)

Eshte kerkuar 1 manovrator per mjetin fadrome me goma .

c) Puntore te thjeshte (44)

Jane kerkuar 44 punonjes te thjeshte sipas zberthimit te preventivit ne metodologjine e hartuar nga komisioni i hartimit te specifikimeve teknike bashkengjitur dst.

2.3.8 Operatori ekonomik, duhet të përcaktojë me anë të një **Deklarate sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit**, një punësim mesatar i të paktën 56 (pesedhjet e gjashte) punonjësve për muajin e fundit.

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

- a. **Vërtetim** të lëshuar dhe konfirmuar (*me firme dhe vule*) nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit.

Dhe

- b. **Listpagesat** e konfirmuar (*me firme dhe vule*) nga Administrata Tatimore të punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.

Per kriteret e percaktuara me lart eshte kerkuar qe operatori ekonomik te ketë një staf prej 56 punonjësve për të realizuar punimet .Totali i numrit të punonjësve eshte vendosur bazuar ne metodologjine e kryerjes se sherbimit nga komisioni per llogaritjen e fondit limit dhe Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në volumet dhe orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë totale punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me

natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim te paktën 56 persona është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen shërbimeve si dhe VKM per kohen e punes ne muaj per punonjes. Po t'i referohemi preventivit, VKM, relacionit, matjeve përkatëse që janë bërë është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve per periudhen e kerkuar me siper*specifikimeve* .

2.3.9 Operatori ekonomik duhet te deklaroje ne formularin e vetdeklarimit se duhet te kete ne pronesi ose me qira mjetet e domosdoshme per realizimin e kontrates si dhe pajisjet si me poshte :

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
1. Kamion teknologjik me mase maksimale te autorizuar sipas lejes se qarkullimit 5 ton deri 7 ton	<i>3 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
2. Kamion teknologjik me mase maksimale te autorizuar sipas lejes se qarkullimit 7 ton deri 10 ton	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
3. Makine teknologjike per fshirje rruge	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
4. Kamion veteshkarkues me mase maksimale te autorizuar sipas lejes se qarkullimit nga 7 ton deri 10 ton	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
5. Autobot uji me kapacitet mbajtes jo me pak se 5.000 litra uje.	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
6. Makine per vijezim rruge me boje biokomponente	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
7. Fadrome me goma	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,si më poshtë :

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

per mjetet ne pronesi :

- 1. Leje qarkullimi (e vlefshme)*
- 2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)*
- 3. Police sigurimi (e vlefshme)*
- 4. Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme*

5. *Certifikate per leje transporti te leshuar nga Bashkia*

dhe per mjetet me qera :

1. *Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
2. *Leje qarkullimi (e vlefshme)*
3. *Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)*
4. *Police sigurimi (e vlefshme)*
5. *Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme.]*
6. *Certifikate per leje transporti te leshuar nga Bashkia*

Ne rastin e mjeteve me qera sipas njoftimit te APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 ,referuar dokumentacionit ,mjetet nuk duhet te rezultojne vetem per perdorim vetjak por edhe per perdorim nga te tretet.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten :

per mjetet ne pronesi :

- *aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*

per mjetet me qera :

- *të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*

- *aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*

Mjetet e kerkuara jane vendosur sipas metodologjise se sherbimit te hartuar nga komisioni per llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike.

Mjetet e mesiperme jane kerkuar per grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave urbane si dhe sherbimeve mbeshtetese , te kerkuara per realizimin e kontrates

Kamion teknologjik me mase maksimale te autorizuar sipas lejes se qarkullimit 5 ton deri 7 ton dhe Kamion teknologjik me mase maksimale te autorizuar sipas lejes se qarkullimit 7 ton deri 10 ton per grumbullimin e mbetjeve sipas metodologjise bashkengjitur.

Fadrome me goma .Ak arsyeton qe prania e nje mjete te tille eshte i domosdoshem per ngarkimin ose mbledhjen e mbetjeve te ngurta te cilat nuk mund te behen me fuqi punetore

Makine teknologjike per fshirje rruge sipas zberthimit te preventivit per sherbimin e fshirjes se rrugeve kerkohet 1 makine fshirese.

Autobot uji me kapacitet mbajtes jo me pak se 5.000 litra uje. sipas zberthimit te preventivit per sherbimin e larjes se rrugeve kerkohet 1 autobot.

Makine per vijezim rruge me boje biokomponente bazuar ne zerat e prventivit per sherbimin e vijezimit eshte kerkuar nje makine per vijezim rruges.

Kamion veteshkarkues me mase maksimale te autorizuar sipas lejes se qarkullimit nga 7 ton deri 10 ton .Eshte kerkuar nje kamion me mase maksimale 7-10 ton per transportin e materialeve te ngurta.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit përgjegjës për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. *Mjetet e kerkuara jane vendosur sipas metodologjise se sherbimit te hartuar nga komisioni per llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike.*